



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0235

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vjosa Gradinaj- Kryetare, Agon Ramadani-Referues Vedat Poterqoi duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) “PE-Vla-Ku sh.p.k.”, dega në Kosovë-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të banimit social-faza e dytë”, me Nr. të prokurimit 632-23-1544-5-2-1, iniciuar nga Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK), me 07.07.2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar, ankesa e OE “PE-Vla-KuSHPK.” Dega në Kosovë, e parashtruar në OSHP me 27.04.2023 numër protokolli 0235/23, kurse Vendimi i Autoritetit Kontraktues i komunikuar me njoftimin e datës 12.04.2023 për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të banimit social-Faza e dytë”, me numër të prokurimit 632-23-1544-5-2-1, vërtetohet.

2. Konfiskohet shuma e mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimin të ankesës, me ç’ rast mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sikurse parashihet me nenin 31 paragrafi 5, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 01.05.2023, AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë, ndërsa me 23.03.2023 ka bërë hapjen e ofertave, lidhur me aktivitetin e prokurimit, i përshkruar si në hyrje të këtij vendimi. Kurse, me 22.05.2023, AK ka publikuar njoftimin mbi Vendimin e tij/sajë, sipas të cilit për kontratë është rekomanduar Grupi i OE “Ideor Construction SH.P.K.&N.N.P. Euro Construction &A and E SH.P.K. Prishtinë.

Me 18.04.2023, tani ankuesi, ka bërë kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar, me Vendimin e AK të datës 20.04.2023.

Me 27.04.2023, kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, ankuesi OE “PE-Vla-Kush.p.k” ka ushtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër të protokollit 235/2023.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 07.05.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Ankesa të refuzohet si e pa bazuar;

Të mbet në fuqi Vendimi i AK i datës 12.04.2023;

OSHP i ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës, me ç ‘rast AK ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq ankuesi “PE-Vla-KuSHPK.” me datë 31.05.2023, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashitjet e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator, sikurse parashihet me nenit 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP. Paneli shqyrtuespas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të

palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli. Lidhur me këtë konstatohet se:

OE "PE-Vla-KuSHPK" nga cilësia e tij si ankues ka pohuar se GOE i rekomanduar për kontratë, nuk e ka plotësuar kërkesën sipas dosjes së tenderit (DT) dhe njoftimin për kontratë (NJK) duke aluduar në këtë rast në Vërtetimin e Administratës Tatimore dhe Vërtetimin e Gjykatës. Mirëpo, sipas raportit të ekspertit shqyrtues (por edhe në shikim të shkresave tjera të kësaj lënde) konstatohet se në fakt dy dokumentet e cituara si më sipër janë dorëzuar në versionin elektronik (në e-prokurim), duke vepruar në këtë rast, ashtu sikurse është kërkuar dhe nga AK.

Ankuesi ka pohon po ashtu se, GOE rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e DT dhe NJK, lidhur me qarkullimin financiar i cili na GOE kërkohet të jetë së paku në shumën 600.000.00 €, përderisa nga Lideri i GOE, kërkohet që qarkullimi në rastin konkret ti referohet shumës prej së paku 60%. Duke ju referuar në këtë rast hulumtimeve dhe analizave paraprake sikurse janë shpjeguar ato në detaje në raportin e ekspertizës dhe duke i krahasuar të njëjtat dhe me shkresat tjera të kësaj lënde, Paneli konstaton se GOE i ka plotësuar kërkesat e cituara si më sipër, nga të dyja aspektet, sikurse është kërkuar paraprakisht me DT dhe NJK, duke e cituar në këtë rast se totali i përgjithshëm i qarkullimit financiar të këtij grupi të OE është vërtetuar se është 674,437.84 € (pa nevojë që të gjitha detajet të përfshihen sërish në përsëritje apo përshkrim).

Ankuesi ka pohuar më tej, se GOE të rekomanduar për kontratë, nuk e ka përmbushur DT dhe NJK në kuptim të kërkesës, sipas së cilës OE nga cilësia e ofertuesit eventual, respektivisht GOE në këtë rast, është dashur të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte të natyrës së ngjashme në 3/tri vitet e fundit. Paneli shqyrtues, natyrisht mori në konsideratë pohimin ankimor në këtë rast dhe duke e krahasuar me shkresat e kësaj lënde dhe raportin e ekspertit shqyrtues konstatohet se GOE i ka dorëzuar listat përkatëse në cilësi të provës lidhur me kontratat e realizuara (së paku nga dy anëtarët e konzorciumit) përfshirë dhe liderin e këtij Grupi të OE të cilët e mbulojnë vlerën e kërkuar nga AK, sikurse shpjegohet në mënyrë profesional dhe argumentuese edhe në ekspertizë, pa nevojë që të gjitha kontratat dhe shumat e tyre të përshkruhen në arsyetimin e këtij vendimi, përderisa të njëjtat evidentohen në shkresat e kësaj lënde.

Krahas tjerash, Ankuesi ka pohuar se GOE të rekomanduar nuk e ka plotësuar DT dhe NJK edhe në kuptim të kërkesës së AK, sipas së cilës duhet prezantuar lista me më së paku 15 punëtor, përfshirë stafin e mjaftueshëm profesional (i specifikuar në pikat a,b,c,d) dhe natyrisht krahas

kësaj dhe dëshmitë e tyre profesionale. Lidhur me këtë, posaçërisht duke u bazuar nga shpjegimet e dhëna në raportin e ekspertizës konstatohet se GOE i rekomanduar për kontratë, e ka dorëzuar listën e punëtorëve dhe përbërjen e stafit profesional në harmoni me kërkesat e publikuara në DT dhe NJK.

Kurse pretendimet ankimore të paraqitura nga OE ankues që kanë të bëjnë me OE MBB Construction shpk, paneli shqyrtues mbështet gjetjet e ekspertit shqyrtues të paraqitura në raportin e ekspertizës dhe të njëjta janë irelevante për shkak se AK ka rekomanduar për kontratë OE që është i përgjegjshëm dhe ka çmim më të lirë, në harmoni me nenin 1 dhe 6 të LPP.

- Përfundim -

Paneli vëren se për secilin rast dhe/ose pohim ankimor, në raportin e ekspertizës gjenden hulumtime, analiza dhe shpjegime të mjaftueshme profesionale dhe të argumentuara sipas së cilave Paneli krijoi bindjen e pavarur se GOE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kriteret e parashikuar me DT dhe NJK dhe se AK në rastin konkret ka vepruar në harmoni me dispozitat dhe parimet bazë të LPP dhe nuk shkelje të dispozitave të cilat janë pohuar në ankesë, përfshirë nenin 1, 7, 27, 59, 60, 61, 69 dhe 72.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i aprovuar në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Andaj nga të lartcekurat, Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - KOMUNA E GJAKOVËS
- OE - PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË
- Arkivës së OSHP-së: